

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-070/13

Prishtinë, 28 May 2015

Në çështjen juridike të:

M P

N R 226

85... S

M

duke vepruar në emër të

së ndjerës **S I** apo **pasardhësve të saj ligjor**

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/156/2012 të datës 6 qershor 2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA17663 & KPA28987 & KPA28988), në tekstin e mëtejme po ashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 28 maj 2015, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Refuzohen si të pabazuara ankesat e paraqitura nga **M P** kundër Vendimit të **KKPK-së nr. KPCC/D/A/156/2012**, të datës 6 qershor 2012.
2. Konfirmohet vendimit i **KKPK-së nr. KPCC/D/A/156/2012**, i datës 6 qershor 2012sa i përket kërkesës me numrin **KPA17663 & KPA28987 & KPA28988**.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 8 dhjetor 2006 M P, i lindur më 20 shtator 1956, (në tekstin e mëtejme: Përfaqësuesi i pretenduar) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave të tokës, zona kadastrale Gorazhdefc, në Graboc, komuna Pejë, numrat 498/1 dhe 498/2, me sipërfaqe prej 1.57.41 ha dhe 1.06.87 ha respektivisht (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Në formularin e kërkesës ai deklaroi se babai i tij M P ka qenë bartësi i së drejtës pronësore. AKP-ja e ka regjistruar këtë kërkesë me numrin KPA17663.

2. Përfaqësuesi i pretenduar së bashku me kërkesën në AKP dorëzoi *inter alia*:
 - Kopjen e planit kadastral nga komuna kadastrale Gorazdefc, Pejë, të datës 26 prill 1972 (në tekstin e mëtejme: kopja e planit); sipas kësaj kopje të planit, shfrytëzuesi/pronari apo uzufukti i pronës së kërkuar ka qenë S I, mbiemri i vajzërisë P;
 - Një dokument të titulluar “Autorizim” të datës 28 prill 1972 (në tekstin e mëtejme: Autorizimi), ku thuhet *inter alia*:
Unë përmes kësaj e autorizojë nipin tim P M, nga Peja, se ai mundet që në emrin tim të bëjë kontratë mbi ndarjen dhe shpërbërjen e ekonomisë familjare me vëllain P M (...) për të cilën pronë nga (...) Gorazdevac (...) ngastrat kadastrale nr: (...) 498/1 dhe 498/2 (...) Përfaqësuesi im P M (...) mundet, në emrin tim, të lidh kontratë për ndarjen dhe transferimin e tërë pronës te vëllai im M, ai gjithashtu mund ta konfirmojë këtë fakt gjatë procedurës kontestimore apo jo-kontestimore për ndarjen (...) Autorizimi i dhënë nga: S I, mbiemri i vajzërisë P, nga fshati Brežanik.
 - Çertifikatën e datës 23 tetor 2007; sipas kësaj çertifikate, I S, mbiemri i vajzërisë P, ka vdekur më 10 mars 1972.

3. Sipas raportit të verifikimit nga AKP-ja, të datës 1 shkurt 2007, pas verifikimit në Departamentin e Kadastrit, kopja e planit kadastral është gjetur dhe KPA-ja ka shtuar ex officio në shkresat e lëndës kopjen e fletës së posedimit nr. 128, të datës 30 janar 2007, zona kadastrale Gorazhdefc, komuna Pejë. Sipas kësaj liste, inter alia, ngastrat me numrat 498/1 dhe 498/2, janë në emër të S I (P).

4. Kur përfaqësuesi i pretenduar u ballafaqua nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së me faktin se babai i tij nuk është përmendur si bartës i së drejtës pronësore në kopjen e planit dhe fletën poseduese por I S, përfaqësuesi i pretenduar u përgjigj se I S është halla e tij. Ai më 14 shtator 2007 paraqiti dy kërkesa të reja për ri-posedim të pronës së kërkuar, duke theksuar se halla e tij I S është

bartësja e të drejtës pronësore të pronës së kërkuar dhe se ajo kishte vdekur në vitin 1972. AKP-ja e regjistroi kërkesën e re që i referohet ngastrës 498/1 me numrin KPA28987 dhe kërkesës së re që i referohet ngastrës 498/2 me numrin KPA28988.

5. Përfaqësuesi i pretenduar dorëzoi në AKP me këto kërkesat e reja *inter alia*:
 - Kopjen e planit;
 - Autorizimin;
 - Çertifikatën e vdekjes të datës 23 tetor 2007; sipas kësaj çertifikate I S, mbiemri i vajzërisë P, kishte vdekur më 10 mars 1972.
6. Përfaqësuesi i pretenduar deklaroi gjatë procedurës para AKP-së se halla e tij kishte vdekur më 10 maj 1972 dhe jo më 10 mars 1972 sikurse është cekur në çertifikatën e vdekjes.
7. Asnjë person tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së.
8. KKPK-ja vendosi t'i refuzojë kërkesat KPA17663, KPA28987 dhe KPA28988. Për arsyetim, KKPK-ja në vendimin e vërtetuar i referohet paragrafëve 12, 201 dhe 202 në Vendimin Grupor. Në arsyetimin e saj, për aq sa është relevante, KKPK-ja thekson se përfaqësuesi i pretenduar i kishte paraqitur kërkesat në cilësinë e tij si anëtar i familjes së ngushtë të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, gjegjësisht babait të tij, dhe përfaqësuesi i pretenduar e dërgoi Autorizimin si autorizim nga halla e tij. KKPK-ja arsyeton se autorizimi nuk ka qenë e mundur të vërtetohet si i vërtetë. Sipas çertifikatës së vdekjes halla kishte vdekur në mars të vitit 1972 dhe nuk ka mundur ta jep autorizimin në prill të vitit 1972. KKPK-ja po ashtu vëren se prona e kërkuar është e shënuar në emër të hallës dhe jo në emër të babait, bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.
9. Vendimi iu dorëzua përfaqësuesit të pretenduar më 15 mars 2013.
10. Përfaqësuesi i pretenduar ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 11 prill 2013. Referenti i Gjykatës Supreme e regjistroi ankesën me tre numra të lëndës, ku secila lëndë i referohet njëtrësisht nga tre kërkesave pranë AKP-së: GSK-KPA-A-07/2013 për KPA17663, GSK-KPA-A-071/2013 për KPA28987 dhe GSK-KPA-A-072/2013 për KPA28988.
11. Përfaqësuesi i pretenduar dorëzoi me ankesën e tij *inter alia* katër "Autorizime". Sipas këtyre autorizimeve S M J, S S, S B dhe B N më 20 korrik 2009 autorizuan palën ankuese që pronën e kërkuar të nënës së tyre të ndërjerë I S, mbiemri i vajzërisë P, ta ketë 'në dispozicionin e tij'. Ata më

tutje e autorizuan atë që *'ta shes, dhurojë, tjetërsojë'* pronën e kërkuar *'në ndonjë mënyrë tjetër'* dhe *'ta nënshkruajë kontratën'* në emër të tyre *'në gjykatën komunale kompetente dhe po ashtu t'i nënshkruajë dokumentet tjera të nevojshme për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë në librat e regjistrit të tokave'*.

12. Asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën para Gjykatës Supreme.
13. Në aktvendimin e saj, të datës 21 gusht 2013, Gjykata Supreme i bashkoi këto tre lëndë në lëndën me numër GSK-KPA-/A-70/13.
14. Më 21 gusht 2013, Gjykata Supreme lëshoi një urdhër gjykate. Sipas këtij urdhri, nga përfaqësuesi i pretenduar është kërkuar që:
 1. Ta dorëzojë vendimin e trashëgimisë, që vërteton se kush janë pasardhësit ligjor të bartëses së pretenduar të së drejtës pronësore I S, e cila ka vdekur në vitin 1972 (pala ankuese pretendon se S J, S S, S B dhe B N janë trashëgimtarët, por për këtë nuk ka prova në shkresat e lëndës, nuk ka vendim të trashëgimisë apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon se këta persona janë trashëgimtarët e bartëses së drejtës pronësore)
 - dhe
 2. T'i shpjegojë Gjykatës se në çfarë mënyrë humbja e pronës së kërkuar ndërlidhet drejtpërdrejtë me apo rezulton nga konflikti i armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 (Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), duke pasur parasysh se bartësja e pretenduar e së drejtës pronësore kishte vdekur në vitin 1972 dhe duke pasur parasysh se nuk ka të dhëna se kush i kishte shfrytëzuar pronat pas vdekjes së saj.
15. Në përgjigjen për gjykatën përfaqësuesi i pretenduar deklaroi në një letër, të datës 2 mars 2015, se procedura e trashëgimisë nuk ishte filluar pas vdekjes së hallës së tij I S. Prandaj, është e pamundshme që të dorëzohet vendimi i trashëgimisë. Ai gjithashtu i referohet autorizimeve të dhëna nga fëmijët e hallës së tij, dhe me këtë përgjigje ai dorëzon edhe certifikatat e lindjeve të këtyre fëmijëve si provë e trashëgimtarëve ligjor. Ai më tej deklaroi se babai i tij, ai dhe familja e tij e kishin shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në shpërthimin e konfliktit.

Pretendimet e palës

16. Përfaqësuesi i pretenduar në ankesë pretendon se është e pavend që për shkak të mungesës së një certifikatë të vlefshme të vdekjes për hallën e tij të ndjerë I S kërkesat duhet të refuzohen. Ai përsërit se data e vdekjes së hallës së tij në certifikatën e vdekjes është e pasaktë pasi që ajo kishte vdekur më 10 maj 1972. Ai gjithashtu thekson se është i autorizuar që të paraqesë kërkesë

në emër të bartëses së drejtës pronësore apo të trashëgimtarëve të saj ligjor dhe i posedon autorizimet e aprovuara nga halla e tij më 28 prill 1972 dhe fëmijët e saj si pasardhësit ligjor të cilët e kanë autorizuar që pronën e kërkuar ta ketë në dispozicionin e tij. Ai propozon që të anulohet vendimi i KKPK-së dhe që lënda të kthehet për shqyrtim të ri nga KKPK-ja.

Arsyetimi ligjor:

Meritat e ankesës

17. Sipas deklaratave të përfaqësuesit të pretenduar në ankesë, ai e paraqet ankesën në cilësinë e përfaqësuesit të bartëses (së pretenduar) të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar. Ai deklaron se halla e tij apo fëmijët e saj janë bartësit e së drejtës pronësore. Pra, ai tashmë nuk deklaron se e përfaqëson babanë e tij. Prandaj, Gjykata Supreme nuk mund t'i përgjigjet pretendimeve që ai i ka bërë në mbështetje të kërkesës KPA17663.
18. Për aq sa ai ka ndërmend të paraqes ankesë si përfaqësues i hallës e tij (të ndjerë) apo fëmijëve të saj, Gjykata Supreme e kupton ankesën e tij si diçka që ka për qëllim të merret një vendim rreth çështjes nëse ai kishte të drejtë që të përfaqësonte bartësin (e pretenduar) të së drejtës pronësore dhe për të paraqitur kërkesat në KKPK.
19. Për aq sa ai ka ndërmend të paraqes ankesë si përfaqësues i hallës e tij (të ndjerë) apo fëmijëve të saj, Gjykata Supreme e kupton ankesën e tij si diçka që ka për qëllim të merret një vendim.
20. Për aq sa përfaqësuesi i pretenduar ende deklaron se përfaqëson hallën e tij, ky pretendim duhet të lihet anash. Sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligji i UNMIK-ut 2006/50), për aq sa është relevante, dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile do të jenë të zbatueshme mutatis mutandis për këtë procedurë. Sipas nenit 95 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, nëse një person vdes autorizimi i dhënë nga ai person bëhet i pavlefshëm. Kështu që, edhe nëse Gjykata Supreme do ta besonte përfaqësuesin e pretenduar në pretendimin e tij se halla e tij ia ka dhënë ndonjë të drejtë që ta përfaqësojë atë dhe se autorizimi i saj gjithashtu përfshinte paraqitjen e kërkesës në AKP, ky autorizim tashmë nuk është i vlefshëm. Kështu që autorizimi nuk mund të paraqes bazë për të që ta përfaqësojë bartësen (e pretenduar) e së drejtës pronësore. Para KKPK-së.
21. Për aq sa përfaqësuesi i pretenduar dëshiron t'i përfaqësojë fëmijët e hallës së tij, ai gjithashtu nuk i ka paraqitur provat e domosdoshme. Fillimisht, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë për

pretendimin se të katër fëmijët apo njëri prej tyre e ka trashëguar pronën e kërkuar. Po ashtu, si reagim ndaj Urdhrit të Gjykatës, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë të tillë. Por edhe nëse Gjykata Supreme do ta lejonte pretendimin e tij – të argumentuar me certifikatat e lindjes – se këta katër janë fëmijët e hallës së tij dhe se ata e kanë trashëguar pronën e kërkuar, edhe atëherë autorizimi nuk do t'i mjaftonte që t'i përfaqësojë ata në procedurën para KKPK-së. Autorizimet e dhëna sipas formulimit të tyre e autorizojnë përfaqësuesin e pretenduar që pronën e kërkuar vetëm ta ketë në dispozicion, ta shes, dhurojë, apo tjetërsojë ose të nënshkruajë kontratë për pronën e kërkuar dhe të nënshkruajë ndonjë dokument tjetër të nevojshëm për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë në librat e regjistrimit të tokave. Sipas këtij formulimi, ata nuk e autorizojnë atë që t'i përfaqësojë ata në procedurë gjyqësore sikur kjo para KKPK-së, sepse kjo procedurë është rreth pretendimit të të drejtave të pronësisë për bartësen (e pretenduar) të së drejtës pronësore.

22. Për hir të korrektësisë, Gjykata Supreme vëren se përfaqësuesi i pretenduar gjithashtu nuk mund ta përfaqësojë bartësen e së drejtës pronësore si anëtar i familjes së ngushtë sikurse parashihet në nenet 1 dhe 5.2 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/5 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Shtojca I e Ligjit UNMIK 2006/50). Sipas nenit 5.2 të Shtojcës I të Ligjit UNMIK 2006/50, në qoftë se një persona fizik nuk është në gjendje të paraqesë kërkesë para KKPK-së, kërkesa mund të bëhet nga një anëtar i familjes së ngushtë të atij personi. Në përputhje me nenin 1 të Shtojcës I të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, anëtari i familjes së ngushtë nënkupton bashkëshortin/en, fëmijën, dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështes në përputhje me ligjin në fuqi, ose personat që janë të obliguar që ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në përputhje me ligjin në fuqi. Përfaqësuesi i pretenduar nuk hyn në këtë përkufizim të anëtarit të familjes së ngushtë sikurse parashihet me ligj. Fillimisht, pronarja e regjistruar e pronës së kërkuar është halla e tij e cila ka vdekur që në vitin 1972, kur paraqitësi i kërkesës ende ishte fëmijë. Nuk ka mundësi tashmë që paraqitësi i kërkesës është i obliguar që ta përkrah hallën e tij financiarisht apo ajo atë. Ai gjithashtu nuk ka argumentuar dhe nuk ka ndonjë të dhënë në shkresat e lëndës se ai dhe fëmijët e hallës së tij të ndjerë hyjnë në këtë përkufizim të anëtarit të familjes së ngushtë.

Konkludim

23. Gjykata Supreme konkludon se KKPK-ja kishte vendosur drejtë kur gjeti se M P nuk e kishte argumentuar se do të mund të përfaqësojë bartësen (e pretenduar) të së drejtës pronësore në procedurën para KKPK-së. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, Gjykata Supreme vendosi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

24. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brower, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it